



Drejtoria e
Përgjithshme e
Tatimeve



PLANI STRATEGJIK
2024-2028
ADMINISTRATA
TATIMORE



Administrata Tatimore 2024-2028

1,450

punonjës nga të cilët :

DRT TIRANË	338
DPT	327
DTM	127
DRT FIER	126
DRT SHKODËR	104
DRT DURRËS	86
DRT ELBASAN	57
DRT KORCË	57
DRT VLORË	47
6 DRT TJERA	181

729,900

numri i

pozicioneve të punës në
listëpagesa Dhjetor 2023

Realizimi faktik i planit të
vitit 2023

102.47 %*

* referuar te ardhurave bruto
(Tatimet+ Rimbursimet +
Kontributet)

/000 lekë

Viti	Ardhura	Rritja nga viti paraardhës
2019	259,461,414	
2020	235,499,428	-9%
2021	274,974,890	17%
2022	308,041,398	12%
2023	366,874,372	19%

/000 lekë

Viti	Rimbursimi	Rritja nga viti paraardhës
2019	23,509,456	
*2020	16,511,532	-30%
2021	24,102,123	46%
2022	22,481,061	-7%
2023	22,614,542	1%

*Si rrjedhojë e efektit të Covid-19 në
ekonominë kombëtare

Viti

Buxheti shpenzuar për 100 lekë
tatim i mbledhur

2019	2020	2021	2022	2023
0.87	1.02	0.91	0.93	0.71

Lloji Deklaratës

Numri Dhjetor
2023

Dek.Sigurime shoqërore	126,632
Dek.Tat.Burim	56,612
Dek.TFTH	104,673
Dek. TF	
Dek.TVSH-së	34,895

Deklarata Individuale Vjetore
e të Ardhurave (DIVA)

Periudha	Nr. i deklaratave DIVA të dorëzuara
2019 (19-A)	13,955
2020 (20-A)	58,353
2021 (21-A)	40,615
2022 (22-A)	41,991

100%

 e deklarimeve tatimore
online nëpërmjet e-filing

SISTEMET

1. e-Tax: C@TS dhe e-filing
2. Fiskalizimi: CPCM dhe SelfCare
3. Regjistri i llogarive Bankare
4. AEOI

Fondi **12.4** miliard lekë për ndihmesë
në paga prej Covid 19.
82.405 TP përfitues
238.601 Individë përfitues



Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm

Që ditën e parë të punës kur Qeveria Shqiptare më dha mundësinë dhe privilegjin e drejtimit të Administratës Tatimore së bashku me stafin tim kemi punuar drejt arritjes së objektivave në dy fusha kryesore:

Arritjen e objektivave të vendosura nga Qeveria Shqiptare, në mbledhjen e të ardhurave që i mundësojnë asaj të ndërtojë një shtet të aftë.

Për të nxitur rritje të qëndrueshme ekonomike dhe zhvillim social që i shërben mirëqenies së të gjithëve shqiptarëve.

Kjo duke e bërë sistemin tonë tatimor sa më të thjeshtë, konkurrues, të drejtë dhe transparent në mënyrë që të lehtësojë përmbushjen vullnetare nga çdo tatimpagues dhe të vështirësojmë mos-përmbushjen përmes rritjes së rregullave dhe kontrolleve në sistem.

Këto janë arsyeja e vërtetë e ekzistencës sonë dhe qëllimi i lartë për të cilin ne shërbejmë.

Megjithatë, sa efektivisht do ta përmbushim këtë mision varet nga disa faktorë të tjerë të cilët përfshijnë:

Kompetencën tonë teknike dhe administrative për të administruar aktet përkatëse;

Mënyrën si e koncepton administrata një plan strategjik;

Aftësinë e saj për të kuptuar dhe për t'u përgjigjur rreziqeve që e shoqërojnë atë.

Ky plan strategjik , i cili mbulon vitet 2024-2028 paraqet një mundësi për administratën tonë për të sqaruar se si planifikon t'i qaset punës së saj si dhe çelësin e rezultateve për të cilat duhet të jetë përgjegjëse.

Plani strategjik 2024-2028 paraqet një vizion frymëzues për të ndërtuar një “administratë të zgjuar dhe moderne, me integritet të padiskutueshëm, të besuar dhe të admiruar. Ai përcakton një qëllim të qartë strategjik për të ndjekur qasjen e njohur ndërkombëtarisht të “pajtueshmërisë vullnetare” dhe e përkthen më tej këtë qëllim në objektiva të qarta si më poshtë:

- Të sigurojë qartësi, siguri, lehtësi për tatimpaguesit në lidhje me detyrimet dhe pagesat e tyre.
- Zbulimi tatimpaguesve, sektorëve ekonomikë që nuk përmbushin dhe të bëjmë të vështirë dhe të kushtueshme mospërmbushjen.
- Rritja dhe zgjerimi i përdorimit të të dhënave brenda një kuadri gjithëpërfshirës të menaxhimit të njohurive për të siguruar integritetin dhe përmirësimin e rezultateve.
- Modernizojmë sistemet tona për të ofruar shërbime online dixhitale dhe të thjeshta.
- Ndërtimi i besimit të publikut në sistemin e administratës tatimore dhe përafrimi i saj me BE-në.



Popullata Tatimpaguesve

334.536

Numri i tatimpaguesve aktive që AT i ka shërbyer gjatë 2023 nga të cilat:

31.058 Biznes i madh

94.545 Biznes i vogël me/pa TVSH

208.933 Të tjera (Individë, OJF, prodhues bujqësor etj)

34.895

deklarues TVSh-je 2023
(2312)

33

e-shërbime gjatë 2023



Popullata Tatimpaguesve

Forma Ligjore	Numri tatimpaguesve
Person fizik	95,403
Prodhues Bujqësor	96,413
Individ privat	94,262
Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara	28,829
Organizatë jo fitimprurëse, Politike, fetare	2'514
Ente publike	1'485
Ambulant	818
Shoqëri aksionere	730
Degë e shoqërive të huaja	387
Trup diplomatik	83
Zyrë përfaqësimi	52
Kryefamiljar	85
Ortakëri e pakufizuar	46
Përfaqësues tatimor	98
Të tjera Forma	13'331
Total	334,536



Vizioni, Misioni dhe Synimet Strategjike 2024-2028



Vizioni – Garantimi i një niveli të lartë të transparencës dhe modernizimit të shërbimeve, drejt një administrate tatimore të spektrit europian



Misioni – Nxitja e përmbushjes vullnetare duke kërkuar nga të gjithë kuptimin dhe respektimin e detyrimeve ligjore në të mirë të zhvillimit të shoqërisë shqiptare



Synimet Strategjike- Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe modernizimi i infrastrukturës teknike për të mundësuar efikasitet me të lartë dhe shërbime të përmirësuara për tatimpaguesit.



**Strategjia për
Përmbushjen**

Kuadër stabil ligjor

Kuadër operacional

Infrastrukturë IT

Trajnim dhe edukim

Performance



Treguesit e efijensës së Administratës Tatimore

Thjeshtësia dhe transparenca

Një tatim i thjeshtë, transparent dhe i kuptueshëm, siguron më shumë të ardhura dhe më pak evazion.



Harmonizimi/ koordinimi me sistemet e tjera

Rritja e numrit të të dhënave dhe shkëmbimit të informacionit me palët e treta.



Kapacitet i lartë gjenerues i të ardhurave

Përdorimi me efijensë dhe efikasitet i burimeve të AT-së.



Zgjerimi i Bazës së Tatueshme

Zgjerimi i bazës së tatueshme duke përfshirë si bizneset dhe individët.



Vizibiliteti dhe Integrimi

Konsolidimi i procesit të fiskalizimit si reforma më e rëndësishme për uljen e hendekut tatimor.



MBLEDHJA E TË ARDHURAVE TATIMORE DUKE NXITUR PËRMBUSHJEN VULLNETARE



OBJEKTIVAT:

- Fuqizimi i menaxhimit të riskut lidhur me regjistrimin, dorëzimin e deklaratave tatimore, raportimin dhe përmbushjen e pagesave. Përdorimi i të dhënave në procesin e vendimmarrjes.
- Lehtësojmë përmbushjen duke iu dhënë tatimpaguesve shërbime të përshtatshme e të mirë-konceptuara.
- Vështirësojmë mos-përmbushjen përmes rritjes së kontrolleve dhe rregullave në sistem.

MODERNIZIMI



OBJEKTIVAT:

- Sigurimi i sistemeve bashkëkohore të IT-së, proceseve dhe mjeteve për tatimpaguesit dhe personelin.
- Digjitalizimi i shërbimeve me efekt reduktimin e kostove të përmbushjes.
- Përmirësimi i të dhënave që administrohen nga AT, nëpërmjet rritjes së komunikimit me institucionet e tjera publike pale të treta dhe implementimit të regjistrave që administrohen prej tyre



DPT



MISIONI:

Nxitja e përmbushjes vullnetare duke kërkuar nga të gjithë kuptimin dhe respektimin e detyrimeve ligjore në të mirë të zhvillimit të shoqërisë Shqiptare.

VIZIONI:

Garantimi i një niveli të lartë të transparencës dhe modernizimit të shërbimeve, drejt një administrate europiane.

INTEGRIMI NË BE



OBJEKTIVAT:

- Përafrimi i sistemeve dhe legjislacionit tatimor me Direktivat e BE-së dhe standardet e OECD-së.
- Shkëmbimi i eksperiencave më të mira me administratat tatimore homologe.
- Përmbushja e detyrimeve raportuese në kuadër të planit të rritjes.

PROGRESI ORGANIZATIV I ADMINISTRATËS TATIMORE DHE ZHVILLIMI I KAPACITETEVE NJERËZORE



OBJEKTIVAT:

- Zhvillimi i kapaciteteve, integritetit transparencës dhe aftësive dhe mjeteve që përdorim.
- Fuqizimi i kontrolleve të brendshme dhe profesionalizmit.

Objektivi 1

Rritja e efikasitetit të mbledhjes së të ardhurave tatimore duke nxitur përmbushjen vullnetare

Nën objektivi 1

Fuqizimi i menaxhimit të riskut lidhur me regjistrimin, dorëzimin e deklaratave tatimore, raportimin dhe përmbushjen e pagesave. Përdorimi i të dhënave në procesin e vendimmarrjes.

Rritja e pajtueshmërisë fiskale ka qenë prej kohësh një nga çështjet kryesore për administratat tatimore shqiptare. Roli i AT është të monitorojë dhe vërtetojë korrektësinë e deklaratave tatimore dhe pagesave dhe të bëjë veprime korigjuese kur është e nevojshme, duke zbatuar dispozitat ligjore.

Masat

- ✓ Intensifikimi dhe fokusimi tek analizat e të dhënave dhe kryerja e analizave, për të identifikuar grupet kryesore të riskut të mospërmbushjes, që përbëjnë pjesën më të madhe të hendekut tatimor.
- ✓ Hartimi dhe zbatimi i projekteve sektoriale të përmbushjes tatimore me fokus në sektorë si Turizmi/ Ndërtim/Aktivitetet digjitale me lloje të ndryshme tatimi si TVSH/TB/TF, lokacioni gjeografik dhe madhësia e biznesit.
- ✓ Nxitjen e Përmbushjes nëpërmjet dizenjimit (Compliance by Design)
- ✓ Implementimi i modulit të ri të riskut pjesë e Fiskalizimit, kryerja e analizave bazuar në informacionin e grumbulluar nga procesi.
- ✓ Kuptimi i arsyeve përse nuk janë përmbushës tatimpaguesit dhe hartimi i strategjive që adresojnë çështjet kryesore duke i ndihmuar tatimpaguesit të jenë përmbushës vullnetarë ose të shmangin mospërmbushjen.
- ✓ Rritja e ndërgjegjësimit dhe të kuptuarit të procesit të MRP-së. Përcaktimi i roleve dhe përgjegjësi në të gjithë DPT-në.
- ✓ Sigurimi dhe analizimi i informacionit nga palë të treta si brenda vendit, ashtu edhe përdorimi i informacionit mbi llogaritë financiare sipas kuadrit të Standartit të Raportimit të Përbashkët (CRS).
- ✓ Funksionaliteti i plotë i Drejtorisë së Kontrollit të Specializuar Hartimi i Programit të Përmbushjes dhe përdorimi i qasjes së integruar për realizimin e Strategjisë së Përmbushjes nga Individët me Pasuri të Lartë.
- ✓ Implementimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore, dhe hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe bashkëpunimi i pandërprerë me bizneset duke synuar marrjen e një baze të plotë të dhënash.
- ✓ Ulja e informalitetit në tregun e punës në të 4 komponentët e tij si Mosregjistrimi punonjësve, Mosdeklarimi i saktë i pagës, Mosdeklarimi i saktë i kohës së punës dhe Mosdeklarimi i saktë kategorisë dhe profesionit të punonjësit.

Afatet

2024-2028

2024-2028

2024-2028
2025

2024-2028

2024-2028

2024-2028

2025

2024-2028

2024-2028



Objektivi 1

Rritja e efikasitetit të mbledhjes së të ardhurave tatimore duke nxitur përmbushjen vullnetare

Nën objektivi 2

Lehtësojmë përmbushjen duke iu dhënë tatimpaguesve shërbime të përshtatshme e të mirë-konceptuara.

Kur kemi të bëjmë me tatimpagues problematikë ne udhëhiqemi nga parimi, se sjellja e padrejtë duhet të jetë aq e kushtueshme dhe e rëndë sa cdokush duhet të matet dhe të mendojë mirë pasojat. Cdokush të kuptojë se shteti nuk toleron veprimtari të paligjshme dhe vepron duke ndërmarrë masa parandaluese.

Masat

- ✓ Sigurimi në mënyrë proaktive i shërbimeve dhe informacioneve të orientuara nga tatimpaguesit.
- ✓ Zhvillimi dhe vendosja në përdorim e deklaratave tatimore të parambushura TVSH dhe DIVA.
- ✓ Zhvillimi dhe zbatimi i një studimi të standardizuar të matjes së kënaqësisë së tatimpaguesit.
- ✓ Përmirësimi i performancës tatimore të bizneseve të vogla duke integruar mekanizma të raportimit tatimor dhe duke i bërë të dhënat e verifikueshme më të lehta për t'u siguruar, aksesuar dhe përdorur.
- ✓ Përmirësimi i faqes zyrtare të AT, për ta bërë atë më tërheqëse dhe më informuese për tatimpaguesit dhe vizitorët.
- ✓ Realizimi i promovimit të fushatës informuese për implementimin e plotë të ligjit të ri të “Tatimit mbi të Ardhurat”, nëpërmjet spoteve promovuese.
- ✓ Mirëmbajtja dhe zhvillimi i shërbimeve që i korrespondojnë teknologjisë moderne dhe lehtësimi i përdorimit të këtyre shërbimeve nga tatimpaguesit dhe rritja e cilesisë së komunikimeve të jashtme nëpërmjet përmirësimit e funksionimit efikas të Qendrës së Thirrjeve;
- ✓ Njoftimi për detyrimet tatimore të papaguara në formë elektronike dhe me vullë digjitale para se të fillojnë masat e mbledhjes me forcë.
- ✓ Zgjerimi i përdorimit të marrëveshjeve të shlyerjes me këste të detyrimeve të papaguara, duke përfshirë mundësimin e aplikimit online
- ✓ Monitorimi i vazhdueshëm dhe ruajtja e standartit të vlerësuar me A (TADAT) 2022) i sistemit të automatizuar të kontabilitetit tatimor që ndërfaqet me sistemin e kontabilitetit të MFE-së.

Afatet

2024-2028

2025-2026

2027

2025-2028

2025

2024

2024-2025

2027

2027

2024-2028

Objektivi 1

Rritja e efencës së mbledhjes së të ardhurave tatimore duke nxitur përmbushjen vullnetare

Nën objektivi 3

Vështirësojmë mos-përmbushjen përmes rritjes së rregullave dhe kontrolleve në sistem

Kur kemi të bëjmë me tatimpagues problematikë ne udhëhiqemi nga parimi, se sjellja e padrejtë duhet të jetë aq e kushtueshme dhe e rëndë sa cdokush duhet të matet dhe të mendojë mirë pasojat. Cdokush të kuptojë se shteti nuk toleron veprimtari të paligjshme dhe vepron duke ndërrmarrë masa parandaluese.

Masat

Gjurmimi i mashtrimeve tatimore, evidentimi i rasteve të konsumimit të elementëve të veprave penale dhe dërgimi i autorëve para organeve të Drejtësisë dhe/ose marrja e masave administrative përkatëse;

Kontrolli tatimor i përqëndruar tek tatimpaguesit, risqet dhe sektorët ekonomikë të cilët kanë gjeneruar humbje të konsiderueshme në buxhetin e shtetit;

Zhvillimi i metodave të reja të analizimit të të dhënave në mënyrë elektronike gjatë kontrollit tatimor duke u mbeshtetur gjërësisht në të dhënat e fiskalizimit;

Përmirësimi i kapaciteteve në kontrollin e produkteve me risk të lartë tatimor me qëllim verifikimin elektronik të të dhënave në zinxhirin e transaksioneve;

Përmirësimi i kapaciteteve në kontrollin nga zyra. Përmirësimi i procedurave të kontrollit nga zyra, metodologjisë dhe analizimit të risqeve;

Zhvillimi i kapaciteteve për zbulimin e mashtrimeve tatimore nëpërmjet përdorimit dhe analizimit të informacioneve nga burime të ndryshme, palet e treta, si dhe krijimin e ekipeve të profilizuara;

Përdorimi i qasjes për parandalimin e mashtrimeve tatimore mbështetur në monitorimin dhe komunikimin e vazhdueshëm me tatimpaguesit, në mënyrë që të stimulojnë korrigjimin vullnetar dhe në kohë të sjelljes jo të rregullt;

Përmirësimi i kapaciteteve për analizimin e deklarimeve të tatimpaguesve degë të shoqërive shumëkombëshe dhe gjithashtu mbajta në vëmendje e riskut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Zhvillimi i teknikave të reja të kontrollit tatimor për individët me të ardhura të larta, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e efektivitetit të tyre

Afatet

2024-2028

2024-2028

2024-2028

2024-2028

2024-2028

2024-2028

2028

2025

2024-2028



Objektivi 2

Modernizimi

- Struktura
- Proceset
- Mjetet

Nën objektivi 1

Sigurimi i sistemeve bashkëkohore të TI-së, proceseve dhe mjeteve për tatimpaguesit dhe personelin

Ne jemi duke e bërë procesin e pagimit të taksave sa më të thjeshtë dhe të përshtatshëm për të gjithë tatimpaguesit, gjë që mbështetet nga teknologjia moderne, përfshirë automatizimin Shërbimet tona elektronike na mundësojnë thjeshtimin e kryerja e detyrimeve tatimore ndërsa automatizimi minimizon rrezikun e gabimeve.

Masat

Afatet

- ✓ Harmonizimi i sistemit C@TS dhe sistemit të Fiskalizimit 2025
- ✓ Finalizimi i paraplotësimit të deklaratës së TVSH-së me të dhënat nga librat e shitjes/blerjes nga Fiskalizimi dhe dërgimi automatik i saj në përfundim të afatit ligjor 2025
- ✓ Implementimi i deklaratave të reja të Tatimit në Burim dhe DIVA dhe paraplotësimi i deklaratës DIVA me të dhëna nga deklarata e Tatimit në Burim, përveçse nga listëpagesa dhe dorëzimi i deklaratës DIVA në përfundim të afatit ligjor 2025
- ✓ Publikimi i shërbimit UserTest ne web: tatime.gov.al, për informim masiv të individëve në lidhje me detyrimin për deklarim të DIVA 2025
- ✓ Përmirësim i procedurave të mbledhjes së Borxhit, finalizimi i projektit “Digjiitalizimi i komunikimit me Bankat për bllokimin/zhblokimin e llogarive bankare” 2025
- ✓ Implementimi i deklaratave të reja, në zbatim të Ligjit të ri "Për tatimin mbi të ardhurat“ 2025
- ✓ Vendosja e rregullave në plotësimin e deklaratave (Compliance by Design) 2024-2028
- ✓ Digitalizimi i deklarimit të vendushtrimit të aktivitetit nga tatimpaguesi dhe pronësia e vendushtrimit të aktivitetit 2024
- ✓ Automatizimi i proceseve të kontrollit tatimor, përmes standardizimit të raport-kontrollit dhe teknikave bashkëkohore të e-audit. (FMN) 2026



Objektivat 2024 – 2028

Masat

Afatet

Objektivi 2

Modernizimi

- Struktura
- Proceset
- Mjetet

Nën objektivi 2

Përmirësimi i Proceseve të Rimbursimit të TVSH-së

Sfidë e AT-së është rimbursimi në kohë i TVSH-së dhe kryesisht në zbatimin rigoroz të rimbursimit të TVSH-së. Veçanërisht sektori fason, eksportuesit dhe grumbulluesit janë në një vëmendje të shtuar të AT-së por jo vetëm.

- ✓ **Mbajta e nivelit 0 të stokut të rimbursimeve si dhe 0 marrëveshjet me këste.**
- ✓ **Reduktimi i kohës së miratimit të shumës për rimbursim. Aktualisht mesatarja është 35 ditë synimi është 25 ditë.**
- ✓ **Automatizimi i pagesës së shumës së miratuar për rimbursim nëpërmjet realizimit të lidhjes automatike ndërmjet dy sistemeve, sistemit C@ts të Tatimeve dhe sistemit Afmis të Thesarit.**
- ✓ **Implementimin e procedurës së rimbursimit të TVSH-së me formë ligjore OJF dhe Trup Diplomatik (sipas neneve 63 dhe 64 të udhëzimit të TVSH-së).**

2024-2028

2028

2027

2028



Objektivi 2

Modernizimi

- Struktura
- Proceset
- Mjetet

Nën objektivi 3

Përmirësimi i të dhënave që administrohen nga ATQ, nëpërmjet rritjes së komunikimit me institucionet e tjera publike dhe implementimit Webserviseve të komunikimit elektronik.

Masat

- ✓ Shkëmbimi i informacionit nëpërmjet nënshkrimit të Memorandumeve të bashkëpunimit me palët e treta si DPSHTRR, Kadastrën, AIF, BKH, Regjistrin e Noterëve, Administratën lokale etj.
- ✓ Shkëmbimi i praktikave më të mira me Institucionet Universitare.
- ✓ Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me ekspertë të jashtëm të fushave të caktuara me ndikim në punën e Administratës Tatimore.

Afatet

2024-2028

2026

2026



Objektivi 3

**Progresi organizativ i Administratës
Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve
njerëzore**

Nën objektivi 1

**Zhvillimi i kulturës së duhur, aftësive dhe
mjeteve**

*Të kesh sukses në mbledhjen efikase të
tatimeve dhe taksave dhe të sigurosh një
mjedis të drejtë ekonomik varet nga
përkushtimi, profesionalizmi dhe
kompetenca e punonjësve tanë. Ne e
konsiderojmë thelbësore që t'i japim njerëzve
tanë mundësi zhvillimi, trashigim njohurish
dhe gjenerim njohurish të reja*

Masat

Afatet

- ✓ **Funksionaliteti i plotë i Drejtorisë së re të Administrimit të të Dhënave dhe Drejtorisë së Implementimit të Opercioneve Tatimore.** 2025
- ✓ **Zhvillimi dhe zbatimi i një sistemi efikas për vlerësimin dhe shpërblimin e punonjësve sipas rezultateve të performances.** 2026
- ✓ **Përmirësimi i procesit të zhvillimit të karrierës dhe mundësive të ofruara.** 2024-2028
- ✓ **Zhvillimi dhe përdorimi i një sistemi të menaxhimit të performancës së punonjësve.** 2024-2028
- ✓ **Zhvillimi i programeve afatgjata për trajnime profesionale dhe zhvillimin e karrierës së punonjësve, në bashkëpunim edhe me sistemin universitar e akademik.** 2027
- ✓ **Krijimi i një kulture në vendin e punës ku të gjithë punonjësit të ndihen të vlerësuar dhe të jenë në gjendje të kontribuojnë plotësisht nëpërmjet aftësive të tyre.** 2027-2028
- ✓ **Specializimi i inspektoreve të kontrollit sipas aktiviteteve (sektorëve) dhe ndarja sipas specializimit të kontroleve që kryhen.** 2026
- ✓ **Sigurimi i kushteve të përshtatshme të punës, paisjeve dhe ambienteve moderne për punonjësit e Administratës.** 2025-2028
- ✓ **Automatizimi i veprimeve financiare buxhetore duke u ndërthurur me sistemet aktuale financiare AFMIS dhe SIFQ me qëllimim nxjerrjen e Pasqyrave Financiare nga ky sistem i ri i cili do të ngrihet nga AKSHI në mënyrë të automatizuar.** 2027
- ✓ **Minimizimi i përdorimit të mjeteve dhe lëndëve që burojnë nga burimet natyrore.** 2024-2028
- ✓ **Minimizimi i shpenzimeve operative të administratës të cilat kanë një ndikim mjedisor (leter,karburant,toner etj) në kuadër të përgjegjesisë sociale të administratës sonë.**

Objektivi 3

**Progresi organizativ i Administratës
Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve
njerëzore**

Nën objektivi 2

**Fuqizimi i kontrolleve të brendshme dhe
integritetit**

Çdo punonjës i AT duhet respektojë vlerat e integritetit, transparencës, objektivitetit dhe drejtësisë. Ne jemi të fokusuar në luftën ndaj korrupsionit brenda strukturës sonë

Masat

- ✓ Hartimi dhe zbatimi i Planit të Integritetit për Administratën Tatimore.
- ✓ Zbatimi i një programi të dedikuar për antikorrupsionin.
- ✓ Kryerja e trajnimeve dhe njohja e punonjësve të Administratës tatimore mbi mënyrat e sjelljes (Kodi i Etikës), Ligjin për Bilbilfryrësit dhe Ligjin për konfliktin e interesit.
- ✓ Publikimi i një raporti statistikor për rastet korruptive të punonjësve të administratës tatimore, për të rritur besueshmërinë ndaj publikut.
- ✓ Në mënyrë efektive të komunikojnë rrezikun dhe kontrollet në zonat e duhura të njësisë (Auditi i Brendshëm).
- ✓ Promovimin e etikës dhe vlerave të duhura për njësinë.
- ✓ Sigurimin e menaxhimit efektiv të performancës dhe përgjegjshmërisë së njësisë.

Afatet

2024-2025

2024-2028

2024-2026

2025

2024-2028

2024-2028

2024-2028



Masat

Afatet

Objektivi 4

Integrimi në BE

Nën objektivi 1

Përafrimi i legjislacionit tatimor me Direktivat e BE-së dhe standardet e OECD-së.

Kapitulli 16 te Acquis për tatimet kërkohet harmonizimi i legjislacionit tatimor të Shteteve Anëtare (dhe vendeve aderuese) me atë të BE-së kryesisht në fushën e tatimeve indirekte, përkatësisht për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe detyrimet e akcizës.

- ✓ Harmonizimi i legjislacionit tatimor në Shqipëri me acquis e BE, nën drejtimin e MFE-së.
- ✓ Rritja e ndërveprimit elektronik dhe shkëmbimit të informacionit me administratat e tjera (ngritja e sistemeve të nevojshme IT për zbatimin efikas të standardit OECD Raportimi Vend pas Vendi – Country by Country Reporting - 2027).
- ✓ Krijimi i bashkëpunimit dhe bashkëveprimit elektronik me shtetet anëtare të BE, duke përfshirë ndërlidhjen e sistemeve IT të administratës tatimore shqiptare me ato të Bashkimit European, në kuadër të procesit të integrimit europian dhe zbatimit të detyrimeve që lindin nga Kapitulli 16 Tatimet (përmes rrjetit CCN/CSI dhe përgatitjes për integrimin me sistemet e BE-së VIES/VIDA – 2028).
- ✓ Zgjerimi i gamës së udhëzimeve interpretuese teknike të botuara
- ✓ Vijimi i procesit për implementimin e standardeve minimale të BEPS

2024-2028

2024-2028

2028

2024-2028

2027



Objektivi 4

Integrimi në BE

Nën objektivi 2

Shkëmbimi i eksperiencave më të mira me administratat tatimore homologe.

Globalisht, autoritetet tatimore, duke ndjekur rregullore specifike, evropiane dhe /ose ndërkombëtare, ose duke zhvilluar bashkëpunim dypalësh ose shumëpalësh përmes marrëveshjeve, shkëmbejnë informacion me qëllimin të trajtimit të fenomenit të evazionit fiskal ose shkëmbimit të eksperiencave më të mira në fushën tatimore.

Masat

- ✓ Bashkëpunim me administratat tatimore homologe për shkëmbimin e eksperiencës
- ✓ Organizimi i trajnimeve ndërkombëtare të stafit të Administratës Tatimore.
- ✓ Zbatimi i projekteve me financim të jashtëm, mundësuar nga instrumentet financiare të Bashkimit Evropian dhe/ose nga donatorë të tjerë.
- ✓ Rritja e kapaciteteve të anëtarëve të GNIPE dhe produktivitetit në përdorimin e Platformës së Partneritetit të Integritetit Evropian.

Afatet

2024-2028


2024-2028

2024-2028


2024-2028



Struktura Menaxheriale



Përgjegjësitë dhe detyrat e Grupit Menaxherial





Fazat e Publikimit të Strategjisë

1

Prezantimi në stafin e AT-së.

2

Publikimi në Intranet e AT-së.

3

Prezantimi ndaj palëve të interesuara si:

Qeveria Shqiptare, Ministria e Financave, DPD, Institucione financiare ndërkombëtare me të cilat DPT-ja bashkëpunon.

4

Publikimi në faqen WEB të AT-së.



Drejtoria e
Përgjithshme e
Tatimeve

1990/646

FALEMINDERIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE



0800 00 02/04 22 76 840



DPT@TATIME.GOV.AL



WWW.TATIME.GOV.AL

